

**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2019
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

1. Informacione të përgjithëshme

Shoqëria tregtare Elektrosek Shpk, është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 22 Nëntor 2011 dhe vepron në përputhje me ligjin "Për tregtarë dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjeve të tjera që rregullojnë biznesin. Kapitali rregjistruar i saj është 110'000'000 lekë dhe aktualisht zotrohet nga ortaku i vetëm, Z. Ilir Mane.

Shoqëria është regjistruar në QKB dhe administratën tatimore me NIPT L12122013A.

Selia e shoqërisë sipas ekstraktit të QKB-së është "Rruga e Kavajës, Pallati 100 Vitrinat, Tiranë"

Objekti i veprimtarisë është "Importimin, tregtimin transportimin e mallrave dhe instalimin e mjeteve të sistemit vrojtues, sinjalizues, audioviziv, mjeteve të mbrojtjes kundra zjarrit, pajisjeve të ndërlidhjes, të teknikave të tjera të lejuara nga legjislacioni, si dhe projektimin, instalimin dhe programimin e pajisjeve të telekomunikacionit, radio komunikacionit dhe sistemeve të kontrollit dhe monitorimit në distancë të automjeteve me GPS, si dhe tregtimin dhe instalimin e mjeteve të mbrojtjes kundra zjarrit. Ndërtime dhe mermetim objektesh, import eksport, magazinim dhe përdorim i lëndëve plasëse (eksplozive) për perdorim civil. Kryerja e operacioneve ekonomike e juridike, industriale, prodhuese, tregtare që lidhen drejt për drejt ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së shoqërisë, brënda kuadrit të dispozitave ligjore për realizimin e çdo biznesi të përshtatshëm me arritjen e qëllimit të shoqërisë. Ofrime rrjetesh dhe sherbimesh të komunikimeve elektronike. Ndërtim i linjave me fibra optike. Punime elektrike, ndërtimë për nëninstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë. Impante të sinjalistikës ndriçuese të 2 trafikut, impiante, linja telefonike dhe komunikacioni, impiante të brëndshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, Tv, etj; punime mekanike. Tregtim i makinerive dhe pajisjeve elektrike, elektronike për përdorime industriale, Sisteme Scada, sisteme për monitorimin e ujraleve dhe paisjeve elektronike dhe elektrike." Projektim dhe zbatim të punimeve ne fushën e ndërtimit dhe të montimit, ndërtim të banesave civile, industriale, bujqësore, turistike, shoqërore etj. Kanalizime të ndryshme, punime komunale të mjedisit, punime hidrosanitare dhe të ujësjellësit. Import - Eksport dhe tregtim me shumicë e pakicë të të gjitha llojeve dhe materialeve pajisjeve dhe makinerive të ndërtimit si dhe mallra të ndryshme të gjithë llojeve.



ELEKTROSEK

L12122013A Rruga e Kavajes, Kompleksi '100 Vitrinat', Tirane / Albania
financa@elektrosek.com

Import-eksport dhe trëgtimi i paisjeve me rreze-X. Tregtim me shumicë e pakicë , tregtim të veshjeve të të gjitha llojeve dhe të konfekSIONeve (veshjeve-këpucëve) të ndryshme , tregtimin e mallrave industrial me pakicë e shumicë, import-eksport dhe tregëtim të uniformave policore, ushtarake, mjekësore,profesionale etj. Konfigurim instalim programim sisteme elektronike dhe sigurie. Kabllim linjash për sisteme sigurie dhe elektronike.

Politikat Kryesore Kontabël

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare (individuale) për qëllime të përgjithshme janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të), të përmirësuara, dhe me kërkesat e ligjit "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Kuadri ligjor: Ligji 9228 dt. 29.04.2004 " Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

Kuadri ligjor i aplikuar: Standartet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri. (SKK2)

Baza e përgatitjes së PF: Mbi bazën e konceptit të materialitetit. (SKK1, 1-3)

Parimet bazë për përgatitjen e PF. (SKK1, 40-90)

1. Parimi i njësisë ekonomike, mban në llogaritë e saj aktivet, detyrimet dhe transaksionet ekonomike të veta.
2. Parimi i vijimësisë, veprimitaria ekonomike e shoqërisë është e sigruar, duke mos pasur në plan ose nevojë për ndërprerjen e aktivitetit të saj.
3. Kompensimi, midis një aktivi dhe pasivi nuk lejohet kompensimi, ndërsa midis të ardhurave dhe shpenzimeve ka vetëm në rastet që lejohen nga SKK.
4. Kuptueshmëria e PF është realizuar në masën e plotë për të qenë të qarta dhe të kuptueshme për përdorues të jashtëm qe kanë njohuri të përgjithshme të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit.
5. Materialiteti është vlerësuar nga ana jonë në bazë të tij PF janë hartuar vetëm për zëra material.
6. Monedha raportuese është monedha kombëtare, Lek.
7. Sipas parimeve të kontabilitetit në Shqipëri deklarimet financiare janë përgatitur mbi bazën e konceptit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

2.1 Instrumentet Financiarë

Mjetet monetare përfshijnë, mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, si dhe, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

ELEKTROSEK

L12122013A Rruga e Kavajes, Kompleksi '100 Vitrinat', Tirane / Albania
financa@elektrosek.com

Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të shoqërise dhe aktivitete të tjera të cilat nuk janë aktivitete investuese ose financuese.

Veprimtari investuese janë blerja, dhe nxjerra e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekivalentinë e mjeteve monetare.

Aktivitete financuese janë aktivitetet që çojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të huasë të shoqërisë.

Gjëndja e mjeteve monetare në fund të vitit 2018 është si më poshtë:

	2019	2018
Aktivet monetare	30,005,561.49	2,699,286.24
1 Banka	29,875,540.79	2,623,153.44
2 Arka	130,020.70	76,132.80

2.2 Aktivet dhe detyrimet financiare

Një aktiv finanziar ose një detyrim finanziar njihet vetëm kur shoqëria bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Matja fillestare e një aktivi finanziar ose një detyrim finanziar bëhet me kostot e transaksionit (duke përfshirë edhe çminin e transaksionit) përvèç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion finanziar. Një transaksion finanziar mund të jetë, për shembull, kur shiten mallra apo shërbime dhe kur pagesa shtyhet përtej afateve normale të tregtisë ose kur ajo është financuar me një normë interesit që nuk është një normë tregu. Nëse marrëveshja përbën një transaksion finanziar, matja e aktivit finanziar ose detyrimit finanziar bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të periudhës raportuese, matja e instrumentave finanziarë bëhet si vijon: Instrumentat e borxhit e percaktuara ne pikën 7 dhe 8 te SKK-3 (si llogari, dëftesë ose hua e arkëtueshme ose e pagueshme) maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Instrumentat e borxhit që janë të klasifikuara si aktive afatshkurtër ose detyrime afatshkurtër maten me shumën e paskontuar të mjeteve monetare ose shumave të tjera të pritshme për t'u paguar ose arkëtar, përvèçse kur marrëveshja përbën, në efekt, një transaksion finanziar. Nëse marrëveshja përbën një transaksion finanziar, matja e instrumentit të borxhit bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me një normë tregu interesit për një instrument të ngjashëm borxhi. Në fund të çdo periudhe raportimi, shoqëria vlerëson nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi finanziar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njihen menjëherë shuma për humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.

Nëse, në një periudhë pasuese, shuma e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi ishte njojur zhvlerësimi (si një përmirësim në vlerësimin e pozicionit finanziar të debitorit), rimerret humbja nga zhvlerësimi të njojur më parë ose direkt ose duke rregulluar një llogari zhvlerësimi, në fitim ose humbje.

Aktivet dhe detyrimet finanziar shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata, bazuar ne percaktimet e SKK-2.

ELEKTROSEK

L12122013A Rruga e Kavajes, Kompleksi '100 Vitrinat', Tirane / Albania
financa@elektrosek.com

2.3 Inventarët

Fillimi, inventari njihet atëherë kur shoqëria e ka nën kontroll, pret përfitime ekonomike prej tij dhe kostoja e tij mund të vlerësohet me besueshmëri. Njohja e inventarëve bëhet zakonisht në momentin e përfitimit.

Inventarët maten fillimi me kosto. Kostoja e inventarit përfshin: përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

Kostoja e lëndëve të para, materialeve të konsumit, tokës dhe ndërtesave të blera për rishitje, përbëhet nga çmimi i blerjes, shpenzimet e transportit, taksat e importit, magazinimi, zbritjet dhe shtesat tregtarë dhe të tjera shpenzime të tjera të ngashme (taksat e parimbursueshme).

Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot mesatare të ponderuar e gjeneruar drejtpërdrejt nga sistemi kontabël "Bilanc".

Gjëndja e inventarit në fund të vitit është si më poshtë:

A K T I V E T	2019	2018
Inventarët	21,167,613.80	59,555,638.60
1 Mallra	18,509,018.00	56,010,843.80
2 AAGJM të vendosura tek te tretet	2,658,595.80	3,544,794.80

Zëri AAGJM është zëri i inventarit në përdorim të të tretëve, si GPS të vendosur nëpër klientë sipas kontratave të shërbimit.

Vlerat e inventarit të paraqitura më sipër përpushten me të dhenat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike e kryera në fund të ushtrimit 2019.

2.3 Shpenzimet e shtyra dhe të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara

Në bazë të parimit të të drejtave të konstatuara, shoqëria njeh të ardhurat dhe shpenzimet në periurdhën kontabël së cilës i përkasin. Po ashtu ajo shpërndan shpenzimet e parapaguara në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave.

Shpenzimet e shtyra në fund të vitit janë 986,105.2 Lekë. Këto shpenzime kryesisht janë për siguracione të pasurive të paluajtshme dhe mjeteve të transportit, të cilat janë lëshuar faturat tatumore në vitin 2019, por mbulojnë dhe vitin 2020.

2.4 Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata material (AAM-të) njihen si një aktiv vetëm nëse: aktivit kontrollohet nga shoqëria, është e mundur që përfitme të ardhshme ekonomike nga përdorimi i aktivit të hyrë dhe kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri. Regjistrimi fillostar i AAM-së bëhet zakonisht në momentin e përfitimit të tij nga blerja apo prodhimi. Një element i AAM-së, që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit finanziar, matet me kosto. Në

ELEKTROSEK

L12122013A Rruga e Kavajes, Kompleksi '100 Vitrinat', Tirane / Albania
financa@elektrosek.com

vlerësimin e mëpasshëm shoqëria zbaton si politikë të saj kontabël modelin e kostos dhe e aplikon këtë model për të gjithë klasën e AAM-së që vlerësohet.

Në pasqyrën e pozicionit finansiar një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen kostos së AAM-së vetëm nëse ato përbushin kriteret e përkufizimit të AAM-ve dhe kriteret për njojen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit finansiar. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor.

Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar. Nëse ekziston ndonjë shenjë e tillë, ajo vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivit. Nëse nuk ka të shenja për zhvlerësim, nuk është e nevojshme të vlerësohet shuma e rikuperueshme.

Vlera e amortizueshme e AAM-ve njihet në pasqyrën e të ardhurave, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktivit. Përjashtime bëjnë aktivet afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për groposje), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen.

Amortizimi për të gjitha grupet, llogaritet dhe njihet me *metodën e vlerës së mbetur*, me norma te cilat janë të përaferta me jetegjatësinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normal e përdorura janë në ndërtesa 5 %, pajisjet informatike 25 %, aktivet e patrupëzuara 15%, dhe per aktivet e tjera 20% të vlerës së mbetur.

AAM në fund të viti janë si mëposhtë:

A K T I V E T	Shenimi	2019	2018
Aktivet materiale	4.5	57,421,475.93	55,734,432.82
1 <i>Toka dhe ndërtesa</i>		36,120,340.45	37,794,070.00
2 <i>Mjete transporti</i>		16,441,613.80	4,350,928.00
3 <i>Të tjera Instalime dhe pajisje</i>		4,859,521.68	4,282,951.52
4 <i>Parapagime për aktive materiale dhe në proces</i>		0.00	9,306,483.30

Vlerat dhe klasifikimi në grupe i AAM-ve të pasqyruara në bilanc dhe në tabelën e mësipërme janë të përputhura me të dhënat e inventarizimeve fizike që shoqëria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2019.

Metoda e zgjedhur e amortizimit të AAM-ve ështe metoda mbi vlerën e mbetur, e njejtë me atë që përdoret për qëllime fiskale.

Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar. Drejtimi mendon se përgjithesisht në këtë ushtrim kontabël, nuk ka shenja të rënjes në vlere të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvlerësimë.

ELEKTROSEK

L12122013A Rruga e Kavajes, Kompleksi '100 Vitrinat', Tirane / Albania
financa@elektrosek.com

2.5 Aktivet afatgjata jomateriale

Një aktiv afatgjatë jomaterial (AAJM) njihet vetëm nëse, është e mundur që të ketë përfitime të ardhshme ekonomike, kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri dhe aktivi nuk është rezultat i shpenzimeve të bëra brenda shoqërise për një zë jomaterial. Njohja fillestare e një aktiv jomaterial bëhet me kosto, ndësa vlerësimi i mëpasshëm paraqitet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

AAJM në fund të vitit janë si mëposhtë:

A K T I V E T	2019	2018
Aktive jo materiale:	27,512.80	32,368.00
1 Koncesione,patenta,liçenca,marka tregtare,të drejta dhe aktive të ngjashme	0	
2 Sofëare Bilanc	27,512.80	32,368.00
3 Parapagime për AAJM		

Gjëndjet e llogarive të likujditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventarët fizikë të monedhave në fund të ushtrimit. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të shpallur nga Banka e Shqipërisë.

2.6 Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Matja e të ardhurave bëhet me vlerën e drejtë të arkëtar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtar apo për t'u arkëtar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëherëshme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe e produkteve njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme, i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve, shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe të produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura, shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri, është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen kur, shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri, është e mundshme që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në shoqëri, faza e përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese mund të matet me besueshmëri, kostot e ndodhura për shërbimin, si dhe ato që do të ndodhin përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen.

 6

Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtit ushtrim kontabël. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar.

2.7 Transaksionet me monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj, që plotësojnë kushtet në njohje, regjistrohet në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e menjëhershëm të këmbimit (spot) ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e trasaksionit, por shpesh përdoret një kurs këmbimi, i cili është i përafërt me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, p.sh. një kurs mesatar i një javë ose një muaji mund të përdoret për të gjitha transaksionet e kryera gjatë kësaj periudhe, në secilën prej monedhave të përdorura.

Në fund të çdo periudhe raportuese, zërat në monedhë të huaj përkthehen si me poshtë: zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mylljes (d.m.th. në datën raportuese), zërat jomonetarë që maten me kosto historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit, zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat e këmbimit, që krijojen gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabël aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim (ose humbje) të periudhës kontabël kur ato lindin

Kur një përfitim ose humbje për një zë jomonetar njihet drejtpërdrejt në kapital, atëherë drejtpërdrejt në kapital do të njihet edhe diferenca e këmbimit.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2019 janë kurset zyrtare të Bankës së Shqipërise 1 euro = 121.77 lekë dhe 1 dollar = 108.64 lekë.

2.8 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet si shpenzim tatimor në pasqyrën e performancës, përvèç tatimit të zërave që njihen direkt ne kapital, i cili njihet si një zë i kapitalit.

Detyrimi tatimor aktual njihet në vlerat që shoqëria pritet të paguajë (rimbursojë) mbi bazën e normave tatileve dhe ligjeve tatileve që janë miratuar ose janë në thelb të miratuar në datën e raportimit.

Aktivi ose detyrimi tatimor të shtyrë njihet për tatimet e zbritshme (rimbursueshme) ose të pagueshme në periudhat e ardhshme si rezultat i transaksioneve ose ngjarjeve të kaluara. Këto tatime lindin nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet në pasqyrën e pozicionit financiar dhe njohjes së këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatileve, si dhe nga mbartja e humbjeve tatileve dhe e tatimit të zbritshëm (rimbursueshëm) të papërdorur.

ELEKTROSEK

L12122013A Rruga e Kavajes, Kompleksi '100 Vitrinat', Tirane / Albania
financa@elektrosek.com

Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2019 eshte 15 % aq sa ka qënë në ushtrimin e mëparshëm.

3 Të drejta të arkëtueshme

Të drejtat e arketueshme, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël deklarohen si vijon:

A K T I V E T	2019	2018
<u>Aktivet Afatshkurtra</u>		
Llogari te arketueshme	145,603,884.7	182,388,471.70
1 Nga aktiviteti i shfrytëzimit	145,588,884.70	182,388,471.70
2 Paradhënie për punonjësit	15,000.00	0.00

Në "Nga Aktiviteti i Shfrytëzimit" janë pasqyruar faturat e papaguara për shërbimet e Gps si dhe të shitjes së mallit që shoqëria ka realizuar gjatë ushtrimit me klientët.

Drejtimi mendon se të gjitha kerkasat do të arketohen në një periudhe afatshkurte me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie në vlerë.

Në zërin "Paradhënie për punonjësit" pasqyrohet paradhënet ndaj punonjësve të cailat do të mbyllen gjatë vitit 2020.

4. Detyrime Afatshkurtëra

Detyrimet afatëshkurtra në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël paraqiten:

DETÝRIMET DHE KAPITALI	2,019	2,018
<u>Detyrime afatshkurtëra:</u>		
1 Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	69,994,118.20	100,285,508.80
2 Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore	535,730.00	266,968.00
3 Të pagueshme për detyrimet tatumore	7,253,834.92	4,822,800.44
4 Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	264,309.62	233,690.04
5 Te ardhura te shtyra	3,812,773.70	541,715.80
6 Overdraft	0.00	24,267,230.34
Totali i Detyrimeve afatshkurtëra	81,860,766.44	130,417,913.4
		2

ELEKTROSEK

L12122013A Rruga e Kavajes, Kompleksi '100 Vitrinat', Tirane / Albania
financa@elektrosek.com

"Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit(furnitore)" pasqyron detyrimet ndaj furnitorëve për blerjen e mallrave e shërbimeve, të cilat janë të pa likujduara në fund të ushtrimit. Drejtimi mendon se të drejtat e furnitoreve janë të vlerësuara realisht.

"Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./shëndet." paraqet detyrimet e mbeturë pa u paguar ndaj tatimeve për sigurimet e muajit dhjetor 2019.

"Të Pagueshme për Detyrime Tatimore " përbëhet vetëm nga tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi në burim dhe tatim fitimi i vitit 2019.

"Të Pagueshme për shpenzime të konstatuara" paraqet shpenzimet e telefonit, karburantit dhe energjisë elektrike të cilat janë faturuar në janar 2020, por janë të periudhës dhjetor 2019.

"Të ardhura të shtyra" pasqyrojnë shërbimin e mirëmbajtjes për Bashkinë Sarandë, faturuar në datë 12.12.2019, por që mbulojnë periudhën janar – nëntor 2020, si dhe fatura pwr shwrbimin e gps faturuar në 2019, por që i përkasin vitit 2020.

5. Detyrimet Afatgjata

DETYSRIMET DHE KAPITALI	2,019	2,018
Detyrime afatgjata:		
Hua dhe detyrime te tjera		
1 Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	9,304,434.00	8,213,327.60
2 Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit	20,496,158.2	25,684,158.20
3 Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	0.00	54,645,528.10
4 Të tjera të pagueshme	4,690,277.60	8,550,921.60
Totali i Detyrimeve afatgjata	34,490,869.8	97,093,935.50

Në zërin e detyrimeve ndaj institucioneve të kredisë pasqyrohet huaja e marrë pranë Intesa San Paolo Bank si dhe detyrimin nda Raiffeisen Leasing për blerjen e një autoveture. Gjëndja përpushtet me statmëtin e bankës.

Në zërin të pagueshme ndaj njësive ekonomike Brenda grupit pasqyrohet vlera e blerjës së ndërtesës.

Në zërin të tjera të pagueshme paqyrohet detyrimi ndaj ortakut për dividentin e pashpërndarë.

6. Kapitali dhe rezervat

Kapitali i regjistruar i shoqërisë, i paraqitur në pasqyrën e pozicionit financier, është ndryshuar më anë të vendimit Nr. 46 Datë 05.06.2019, në të cilin është vendosur që fitimi i pashpërndarë i vitit 2018 dhe më perpara si dhe financimi i ortakut në shoqëri të shkojë për zmadhimin e kapitalit.

Gjatë ushtrimit kontabël kapitali i shoqërisë është rritur në 110,000,000 lekë.

ELEKTROSEK

L12122013A Rruga e Kavajes, Kompleksi '100 Vitrinat', Tirane / Albania
financa@elektrosek.com

7. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit dhe të tjera

Të ardhurat e realizuara gjatë ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) të biznesit paraqitet si vijon:

Pasqyra e Performancës	2019	2018
<u>Të ardhura nga aktiviteti i shërbimit</u>	<u>63,919,380.55</u>	<u>77,372,866.63</u>
<u>Të ardhura nga aktiviteti i shitjes së mallrave</u>	<u>242,438,632.87</u>	<u>281,131,586.00</u>
<u>Të ardhura nga aktiviteti i shitjes së AQT</u>	<u>936,170.00</u>	<u>700,000.00</u>

Të ardhurat nga shitja e shërbimeve janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, të zhveshura nga TVSH-ja. Paraqitura ne pasqyrat financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve është bërë sipas natyrës së tyre.

8. Shpenzimet e për lëndë të parë dhe materiale të konsumueshme

Lëndë të para,materiale dhe mallra etj, të konsumuara gjatë ushtrimit, ndarë sipas natyrës së tyre paraqitet si vijon:

<u>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</u>	<u>2019</u>	<u>2018</u>
1 <i>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</i>	<i>203,546,901.82</i>	<i>233,096,536.87</i>
2 <i>Të tjera shpenzime</i>	<i>202,910,044.69</i>	<i>232,320,836.20</i>
	<i>636,857.13</i>	<i>775,700.67</i>

Lënda e parë dhe material të konsumueshme pasqyron koston e mallrave të shitur për periudhën ushtrimore.

Të tjera shpenzime pasqyrojnë blerjen e materialeve të konsumit, si materiale elektrike që përdoren nga teknikët gjatë instalimeve nëpër klientë.

9. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit përbëhen nga pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, leja vjetore e paguar, raporti mjekësor i paguar në 14 ditët e para, pjesëmarrja në fitime dhe shpërblimet.

Numri mesatar i punonjesve dhe shpenzimet vjetore të kryera për personelin janë si me poshtë :

ELEKTROSEK

L12122013A Rruga e Kavajes, Kompleksi '100 Vitrinat', Tirane / Albania
financa@elektrosek.com

Pasqyra e Performancës

Shpenzime të personelit

	2019	2018
1 Paga dhe shpërblime	16,425,649.50	13,070,931.00
2 Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas)	14,078,510.00	11,173,925.00
	2,347,139.50	1,897,006.00

Nr mesatar i punonjësve për vitin 2019 është 30.

10. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Në shpenzime të tjera të shfrytëzimit janë përfshire kostot e shërbimeve kryesore dhe ndihmëse, që lidhen drejprëdrejt me veprimtaritë e shfrytëzimit dhe ato për qëllime administrative, si dhe, kostot që ndodhin jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të biznesit.

Pasqyra e Performancës

Amortizim Aktive

Kosto e AQT-ve të shitura

Amortizim aktive ne perdorim te treteve

Shpenzime të tjera shfrytëzimi

	2019	2018
5,559,490.83	3,075,352.00	
849,906.00	679,657.00	
886,199.00	1,558,109.85	
47,985,811.89	48,891,683.49	

Shpenzime financiare

- 1 Shpenzime interes i dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)
- 2 Shpenzime të tjera financiare

3,560,258.79	4,568,923.43
1,955,906.81	1,755,078.77
1,604,351.98	2,813,844.66

Një analizë e shpenzime të tjera shfrytëzimi paraqitet më poshtë:

ELEKTROSEK

L12122013A Rruga e Kavajes, Kompleksi '100 Vitrinat', Tirane / Albania
financa@elektrosek.com

Përshkrimi	Vlera
Blejer energji elektrike	323,274.51
Blerje uje	30,028.33
Karburant	7,434,682.10
Qira	220,000.00
Mirembajte dhe riparime automjete	1,799,314.66
Mirembajtje dhe riparime te tjera	617,167.00
MIREMBAJTEJ ZYRA	2,549,956.47
Sigurime TPL	209,450.00
Sigurime Kasko	265,452.20
Sigurime pasuri te paluajtshme	127,304.70
SIGURIME KONTRATA	91,200.00
Sigurime transport malli	104,740.00
Te tjera	4,926,101.58
Pagesa per koncesione; patenta	2,359,188.15
Reklama; publicitet	583,620.50
Transferime; udhetim e dieta	2,324,240.47
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	2,461,744.96
Taksa dhe tarifa vendore	395,276.70
Taksa e regjistrimit	3,750.00
TAKSA QARKULLIMI	41,153.67
TE DREJTA AUTORI	33,209.00
Tatim ne burim qera	12,750.00
Uniforma dhe veshje pune	263,774.51
TRAJNIME	38,000.00
KONSUM I BRENDSHEM	5,372,970.00
Shpenzime per pritje dhe perfaqesime	195,629.17
Gjoba dhe demshperblime	59,906.79
Shpenzime kancelari	165,215.00
SHPENZIME AUDITIMI	242,000.00
SHPENZIME NOTERIALE	720,266.67
SHPENZIME TENDER POSTA	12,932,678.33
SHPENZIME TE PANJOHURA	1,081,766.42
Totali	47,985,811.88



ELEKTROSEK

L12122013A Rruga e Kavajes, Kompleksi '100 Vitrinat', Tirane / Albania
financa@elektrosek.com

11. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Janë paraqitur si diferencë e të ardhurave me shpenzimet sipas kërkesave të standarteve.

Pasqyra e Performancës

Të ardhura të tjera

- 1 Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)
- 2 Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)

	2019	2018
1,360,417.01	928,285.28	160,346.45
432,131.73		6,559.32

12. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Në illogaritjen e shpenzimit aktual të tatimit mbi fitimin janë respektuar kërkesat e legjislacionit fiskal. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 20198 është 15%.

Nuk jane identifikikuar aktive, detyrimeve dhe zërave të tjerë që priten të ndikojnë në fitimin e tatushëm nëse ato do të realizoheshin ose shlyheshin me vlerat e tyre kontabël aktuale, që ka të bëjë me krijimin dhe realizimin e diferencave të përkohshme. Për rrjedhim nuk është njojur asnjë tatim fitimi i shtyrë.

Pasqyra e Performancës

Fitimi/Humbja para tatimit

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

- 1 Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin
- 2 Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë
- 3 Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve

Fitimi/Humbja e vitit

	2019	2018
29,840,382.60	54,430,164.76	
4,654,202.22	8,428,449.66	
4,654,202.22	8,428,449.66	
25,186,180.38	46,001,715.10	

ELEKTROSEK

L12122013A Rruga e Kavajes, Kompleksi '100 Vitrinat', Tirane / Albania
financa@elektrosek.com

Shënimet tjetra shpjeguese

13. Ngjarjet pas datës së bilancit dhe vazhdimësia e shfrytezimit

Asnjë ngjarje e rëndesishme nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.

14. Shpjegime mbi palët e lidhura

Me marrjen në konsiderate të çdo transaksi dhe marredhenie të mundeshme, jo thjesht formen ligjore të tyre ne 31 dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 nuk ka transaksione me palët e lidhura.

15. Shifrat krahasuese

Pasqyrat financiare të vitit 2018 janë hartuar dhe paraqitur në përputhje me formatet që janë dhënë në shtojcën e standardit SKK-2,(të përmirësuar) dhe çeljet e vitit 2018.

